



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 526, Datë 14.06. 2018

“Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2018,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja d, dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative në RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi vlerësimin e tregut të ndërmjetësimit në sigurime nga bankat,

VËREN SE :

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet shkresës nr. 1789 datë 18.05.2018 “Mbi inspektimin të ndërmjetësit në sigurime”, konstaton se, kontratat e sigurimit të ndërmjetësuara nga Raiffeisen Bank SHA si ndërmjetës në sigurime gjatë vitit 2017 dhe 3 mujorit të parë të vitit 2018 janë lëshuar vetëm nga shoqëritë Sigal Uniqa Group Austria SHA për sigurimin e pronës dhe Sigal Life Uniqa Group Austria SHA për sigurimin e jetës.

Gjithashtu nëpërmjet shkresës nr. 1452 datë 22.05.2018 “Përcillet ankesë”, shoqëria e sigurimit të jetës XXXXX, paraqet pretendimin se XXXX SHA “refuzon të transmetojë

tek klientët e tyre edhe produktin e sigurimit të jetës për hua të shoqërisë XX SHA” duke mos i dhënë mundësi shoqërisë për të qenë konkurreues në produktet e sigurimit të jetës për hua të.

Në zbatim të nenit 204, pika 5 e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, AMF ka licensuar 4 banka në rolin e ndërmjetësit në sigurime; Raiffeisen Bank SHA, BKT SHA, Alpha Bank SHA dhe se fundmi Bankën Credins SHA.

Tre bankat kryesore në sektorin bankar, RB, BKT dhe BC, të cilat janë edhe ndërmjetës në sigurime, zotërojnë rreth XX % të vlerës së portofolit të kredisë për vitin 2017, duke qenë kredituesit më të mëdhenj të sistemit bankar. Dy prej tyre, Raiffeisen Bank dhe BKT janë gjithashtu bankat të cilat janë objekt dyshimi dhe ankese për sjellje antikonkurreuese.

Në produktin e sigurimit të jetës së debitorit, Raiffeisen Bank ka ndërmjetësuar rreth XX % të kontratave të nënshkruara me ndërmjetësimin e bankave, ndërkohë që BKT ka ndërmjetësuar XX % të këtij shërbimi.

Shoqëria e sigurimit të jetës Sigal Life Unica Group Austria, tek e cila Raiffeisen bank ka ndërmjetësuar kontratat e sigurimit është shoqëria më e madhe në tregun e sigurimit të jetës duke zotëruar mbi XX % të tregut të sigurimit të jetës sipas vlerës së kontratave. Gjithashtu shoqëria Sigal Unica Group Austria zotëron pjesën më të madhe të tregut të sigurimit të pronës nga zjarri dhe forcat e natyre duke zënë rreth XX % të tij. Dy shoqëritë e sigurimit janë pjesë e Uniqa Grup.

Nga sa më sipër, jemi përpara dyshimit të arsyeshëm që dy nga bankat më të mëdha në tregun e kredidhënies mund të paraqesin sjellje abuzive në lidhje me zbatimin e kushteve të ndryshme për veprime të njëjta tregtare me palët në shërbimin e ndërmjetësimin në sigurimin e jetës dhe jo jetës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d dhe nenit 42, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Hapjen e Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimin në sigurime nga bankat e nivelit të dytë
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 31 maj 2018.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS